



INFORMACION PËR KLIENTIN

Lista e Provave dhe Shërbimeve që ndodhet pranë Zyrës së Pranimit të Kampionëve përcakton analizat laboratorike që Laboratorët e ISUV-së mund të kryejnë. Për arsye që dalin jashtë kompetencave të laboratorëve psh. mungesë të bazës materiale, mosfunksionim të pajisjeve, kjo *Listë* mund të mos jetë aktive për disa tregues. Megjithatë, Ju do të informoheni në ambjentet e pranimit të kampionit për analizat që Ne nuk mund t'i ofrojmë.

Kampionimi dhe të dhënat në dokumentat shoqërues të kampionit janë nën përgjegjësinë e plotë të klientit dhe Laboratori nuk mban përgjegjësi për to. Gjithashtu, rezultatet analitike të pasqyruara në Raportin e Provës i përkasin vetëm kampionëve të testuar në laborator.

Kohëzjatja e kryerjes së testeve është e shprehur në ditë punë dhe shpreh kohën kur fillon analiza deri kur Raporti i provës do të jetë gati për t'u tërhequr nga klienti në Zyrën e Pranimit të Kampionëve. Ka raste kur kohëzjatja mund të variojë në funksion të: numrit të treguesve/analitëve të kërkuar, rasteve të dyshimta (ku laboratori duhet të kryej teste shtesë për konfirmim), motivi i kampionimit, si dhe rastet e paparashikuara nga laboratori psh. probleme me pajisjet, ngarkesa e laboratorit. Për këtë arsye kohëzjatja në "*Listën e Provave dhe Shërbimeve*" përfaqëson ditët në të cilat rezultatet mund të bëhen potencialisht disponibël.

Kriteret teknike të pranimit të kampionëve janë mjaft të rëndësishme për ekzekutimin e analizave laboratorike. Nëse ato nuk janë konformë specifikimeve të përcaktuara atëherë kampionët nuk do të pranohen. Gjithashtu, sasia e përcaktuar për njësi shërben si për të kryer korrekt protokollin teknik por dhe në rast të një rezultati dyshues, laboratori ka material për të kryer ritestim për të verifikuar rezultatet analitike.

Laboratorët e ISUV-së, për shkak të detyrimeve ligjore, në rastin e marrjes së rezultateve të analizave jo në përputhje me normat e vendosura në legjislacionin në fuqi, kanë detyrim njoftimin e menjëherë pranë autoriteteve përgjegjëse, referuar Urdhërësave dhe Udhëzimeve në fuqi.

I gjithë dokumentacioni që ka të bëj me kampionin ruhet në ISUV sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Kampionët negative (konform normave) ruhen në kushtet origjinale, sipas kampionit, për një periudhë dy javore pas daljes së Raportit të Provës ndërsa kampionët pozitiv (jokonform normave) për një periudhë 60 ditore nga dalja e Raportit të Provës. Megjithatë, kjo periudhë është e kushtëzuar nga lloji i kampionit, jetëgjatësia e produktit & analitit.

Për informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni me personelin e Zyrës së Pranimi të Kampionëve.

Faleminderit për bashkëpunimin!